



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Kuvendi i Kryeqytetit
Skupstina Glavnog Grada - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Arsim, mbajtur më 22.02.2023,
duke filluar në orën 17:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Dervishi, Lindita Rexhepi, Ajet Brajshori, Gjylbehare Llapi.

Mungoi: Berna Saraçi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i komitetit z. Fatmir Dervishi me këtë

R E N D T Ë D I T Ë S:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja paraprake;
2. Raportim për suksesin e nxënësve në gjysmë vjetorin e parë;
3. Plotësimi dhe aprovimi i udhëzuesit për organizimin e garave komunale;
4. Riorganizimi i mësimit në SHFMU "Dardania", pas fillimit të renovimit;
5. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Raportim për suksesin e nxënësve në gjysmë vjetorin e parë

Kryesuesi i komitetit tha se kjo pikë mbetet për shqyrtim në takimin e ardhshëm.

Pika e tretë

Plotësimi dhe aprovimi i udhëzuesit për organizimin e garave komunale

Fatmir Dervishi, kryesues shtroi pyetje se a ka dikush që të shtojë apo plotësojë diçka lidhur me udhëzuesin për organizimin e garave komunale.

Ai në vazhdim tha se ne si komitet e aprovojmë, sepse mendojmë që ka të mira dhe është i nevojshëm në këtë kohë, pastaj mbetet që zyrtarët e DKA-së, ta shtyjnë përpara, sepse e ka një kosto diku përafërsisht 40 mijë euro. Janë të shkruara shifrat të gjitha, të cilat mund të rriten apo zvogëlohen.

Gjylbehare Llapi, duke u ndërlidhur në diskutim tha se në përgjithësi nuk është shumë i kushtueshëm, mandej duke e ndarë punën tonë, totali nuk dilte shumë.

Fatmir Dervishi, kryesues tha se edhe njëherë po e përsërisë nëse keni vërejtje dhe sugjerime, këtë dokument sot duhet ose me e aprovuar ose me e larguar nga diskutimi.

Ajet Brajshori, duke u ndërlidhur në diskutim tha se unë do ti kisha dhënë mendimet e mia, kam mbetur tek çështja e pikave 5,10,15 tek indeksi se sa me i vlerësuar, ku mendoj që kjo është e qëndrueshme edhe pse pika 15 na sjell më shumë telashe.

Fatmir Dervishi, kryesues tha se ne mundemi me e marr një komision që e bën vlerësimin e testeve, ndoshta i ka jo 5 por i jep 2, 2, a, b, c alternativa.

Ajet Brajshori, tha se këtu dua të ndërlidhem, se brenda pesëshit mundet me qenë me 3 pikë, brenda dhjetëshit mundet me qenë me 7 pikë. Komisioni duhet të vlerësojë me përqindje të përgjigjes se sa ka dhënë ai nxënës.

Fatmir Dervishi, kryesues tha se si teste kemi teste profesionale. Kemi punuar me Skënder Beranin në 2010-ën aty edhe brenda detyrës me 20 pikë thotë; deri këtu 5 pikë, deri këtu 5 pikë., dhe aty janë saktë të matshme, pra kemi modele shumë, kush e merr atë punë do të nënshkruhet atje, pra duhet me qenë profesionistë. Por atë kuotën e pikëve dhe vlerësimin edhe brenda detyrës, duhet patjetër me e pasur.

Ndërsa tek pyetjet me alternativa, aty shkon 2 ose 0, këto të tjerat, pyetjet e mesme apo të nivelit më të lartë, shkojnë 10 pikë, ku deri diku i merr 5, deri diku 3 e kështu me radhë.

Ai në vazhdim tha se aty kemi me vendosur një standard të cilin unë mundem me ua prezantuar, por do kishte qenë mirë që drejtoresha dhe ata që i bëjnë garat me pas parasysh që fëmija kur të vjen, jo me i thënë më duket, s'më duket, por e ke gjetë $X=4$ -ke 10 pikë, Y të mungon- nuk ke pikë, Z e ke gjetë ja ku janë pikët, 10 vite e kemi mbajtur olimpiadën me Skënderbeun dhe kurrë nuk kemi pasur problem.

Ajet Brajshori, tha se testi duhet të jetë i standardizuar, si dhe pyetja duhet të jetë e qartë e jo histori, prandaj ai komisioni i cili i formulon pyetjet duhet të vijë të bisedoj me ne qysh kishim me i dhënë edhe ne idetë tona, mbështetjen dhe profesionalizmin tonë në mënyrë që tek nxënësit mos me krijuar amulli.

Ai mes tjerash tha se sa i përket çmimit për mua është i pranueshëm, sepse me 40 mijë euro me e bërë një punë kaq të madhe, me hyrë në garë me të gjithë personelin dhe me nxënësit, dhe e nxjerrë

një performancë të mirë të garës, nuk është e kushtueshme me e çmuar dijen e nxënësve, 40 mijë euro për mua janë të pranueshme.

Lindita Rexhepi, tha se nuk kisha dashur asgjë më shumë me i shtuar komentit të profesorit Ajet, për arsye se janë shumë me vend dhe unë të njëjtat do i kisha thënë por profesori shumë më mirë i ka përmbledhë, si dhe pajtohem me shumën, bile me shikuar që nëse ka buxhet edhe me rrit nuk bën aspak keq, është e pranueshme edhe kjo shumë sepse përfshihen shumë njerëz.

Fatmir Dervishi, kryesues tha se për mua më e pëlqyeshme do kishte me qenë që një fëmije me ia dhënë 300 euro, e jo një laptop. Do kishte qenë edhe për ne më mirë, ish ditur që po i merr paratë e mos me lënë hapësirë për konfuzion rreth çmimit real të laptopit, prandaj jam i mendimit se do të ishte mirë që t'i drejtohem Zyrës ligjore me një kërkesë për të na njoftuar se a ka të drejtë Komuna ta bëjë këtë.

Ai në vazhdim tha se ne kemi qenë në olimpiadë dhe kemi marrë para. Na ka dhënë shoqata para, mua si profesor 500 euro, nxënësit 1000 euro, ajo ka qenë shoqatë. Shoqata tash mbulohet prej MASHT-it, atëherë nuk e di se kush e ka mbuluar.

Lindita Rexhepi, duke u ndërlidhur në diskutim tha se pajtohem me propozimin e z. Dervishi kishte qenë mirë me u drejtuar me shkrim zyrtarisht Zyrës ligjore që me pas si dokument që në rast se shkojmë me këtë formë që po e diskutojmë, nesër nëse ndodhë me pas ndonjë ankesë, ne me pas dokument që kemi pas konsultë me Zyrën ligjore dhe kemi dokumentin që jemi në rregull me ligj dhe nuk jemi duke e bërë ndonjë shkelje. Praktikisht ne mundemi me pas konsultë me Zyrën ligjore, nuk na kushton asgjë.

Fatmir Dervishi, kryesues tha se unë këtë po e marr po, e përpunoj dhe ua dërgoj me këto vërejtje.

- 1.Vendi i parë, i dytë, shpërblehen sa do që fitojnë,
- 2.Pikët minus me u larguar,
- 3.Me i 'u drejtuar Zyrës ligjore për këtë,
- 4.Mundësisht nëse ka më shumë mjete me i ngritë për secilën kategori.

Pika e katërt

Riorganizimi i mësimi në SHFMU "Dardania", pas fillimit të renovimit

Fatmir Dervishi, kryesues lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se pasi që nuk i kemi prezent drejtoreshën e as zyrtarin tjetër për arsim të cilët kishin me na njoftuar lidhur me riorganizimin e mësimi në SHFMU "Dardania", pas fillimit të renovimit tha se do ju them ca fjalë lidhur me këtë pikë.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se Shkolla "Dardania", e ka fituar një projekt nga Bashkimi Evropian, vlera e të cilit nuk e di saktë sa është por përafërsisht është 600 mijë apo 700 mijë euro.

Ajo do të rinovohet në tërësi duke i përfshirë të gjithat si: kanalizimin, ujin, rrymën, dyshe-menë etj. dhe kjo do të zgjatë deri në shtator të vitit 2024, pra një vit e gjysmë.

Ai në vazhdim tha se për momentin shpërndarja e klasave është bërë vetëm në shkollën "Xhemail Mustafa", sepse një pjesë të aneksit dhe të shkollës e ka marrë kompania dhe ka filluar të punojë, duke i mbyllur muret për të mos pas kontakt me nxënësit.

Po punohet në tri ndërrime. Oraret janë rregulluar, mësimdhënësit janë në rregull, nxënësit janë në rregull, orët e mësimi janë nga 40 minuta, si dhe janë shkurtuar pushimet në mes të ndërrimeve kështu që përveç ndërrimit të tretë që është shtuar çdo gjë tjetër është në rregull.

Lindita Rexhepi, shtroi pyetje se a do të bëhet renovimi i shkollës në total.

Fatmir Dervishi, kryesues duke i'u përgjigjur znj. Rexhepi tha se renovimi do të bëhet komplet. Ai në vazhdim tha se ne e kemi shtyrë këtë proces gati që një vit për shkak të kërkesave sepse kanë pasur me na dërguar në shkolla të tjera, 2200 nxënës sa kemi me na larguar të gjithë. Mirëpo me reagimin tonë, por edhe pak ata deshën të na ndihmojnë, na lanë në shkollë, ndonëse me tri ndërrime por është më mirë, për çka edhe i falënderojmë. Ku njëherit falënderojmë edhe shkollën fillore "Xhemail Mustafa", ku i kemi vendosur 10 -15 klasë kurse këto të tjerat kanë mbetur në objekt.

Gjylbehare Llapi, tha se po më vjen keq që drejtorja nuk qenka prezent se kam një kërkesë prej një klubi të sportit të karatesë, të cilët janë të interesuar të shkojnë në 2-3 shkolla të Prishtinës, mundësisht shkolla publike me ofruar sportin e karatesë gratis për nxënës.

Ajo në vazhdim tha se qëllimi i kësaj është që me i larguar pak fëmijët nga teknologjia dhe me i angazhuar pak në aktivitetet sportive, pasi që nxënësit shumë pak janë duke u marr me aktivitete sportive por më shumë janë dhënë pas teknologjisë.

Ajo mes tjerash tha se ata veç se kanë shprehur dëshirën tek shkolla "Model" ku ata vetëm se ua kishin lejuar, thjeshtë kërkonin që ta përdorin sallën pa pagesë, por është për ata nxënës të asaj shkolle të cilët mund të shkojnë pa pagesë.

Trajneri shkon aty në mënyrë vullnetare. Thjeshtë po kanë dëshirë me i angazhuar fëmijët sepse po e shohin që nuk janë duke u marrë me aktivitete fizike, me aktivitete ekstra kurikulare, dhe po u merr shumë kohë teknologjia.

Prandaj ata pyetën se a me e bërë kërkesën vetë sikur shkollës "Model" që ia kanë bërë, apo me shkuar kërkesa në Komunë, me biseduar me Komunën se cilat shkolla mendojnë ata që do kishte qenë mirë me e ofruar këtë aktivitet.

Fatmir Dervishi, kryesues lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Llapi tha se ata marrin termin në shkollë, kështu është rregulli, mirëpo patjetër drejtori e informon drejtoreshën, kërkesat e terminëve të gjitha shkojnë në DKA, do të thotë ai e bën kërkesën në shkollë e pastaj kërkesa vjen në DKA, kështu që me rregull, pa informatë të DKA-së, nuk lejohet.

Ajet Brajshori, duke u ndërlidhur në diskutim tha se shfrytëzoj rastin të ju informoj se edhe shkolla "Zenit", ka ofruar aftësimin e nxënësve në not. E kanë pishinën brenda, i kanë trajnerët e vet, kanë qenë janë konsultuar tek unë dhe kanë mbetur të bisedojnë me drejtoreshën dhe kryetarin për mënyrën e organizimit, transportin e sigurojnë ata, për cilën do shkollë të Prishtinës. Ku lidhur me këtë ata kanë mbetur të shohin se a po munden me gjetur donacion, pastaj bisedojmë së çfarë mundemi. I kemi trajnerët tonë dhe është shkolla e notimit aty e cila i ka kushtet ideale

sepse kam qenë aty me nxënës dhe është mirë me pas një mundësi me i përfshirë nxënësit, edhe gjatë vikendeve edhe gjatë ditëve të mësimit sepse i kanë autobusët e vetë dhe i bartin nxënësit.

Me disa propozime dhe sugjerime mbetet që të shikohet se çka mundet të bëhet lidhur me kycjen e nxënësve në aktivitete sportive dhe aktivitete tjera qysh kishin me u larguar pak nga teknologjia pasi që ajo po ju merr shumë kohë.

Pika e pestë Të ndryshme

Ajet Brajshori, lidhur me çështjen e bursave tha se çështjen e bursave e kemi diskutuar në një mbledhje, por nuk e di a keni ndonjë informacion se a ka ecë ky proces sepse po pyesin edhe shkollat edhe prindërit.

A do të përfshihet vetëm niveli i shkollave të mesme apo edhe fakultetet?

Ai mes tjerash cekti edhe çështjen e 7 Marsit ku tha se mendova që do të jetë edhe drejtorja, sepse pata me i propozuar një ide që me i ftuar veteranët e arsimit të Komunës së Prishtinës, ndoshta nuk është një numër i madh, sa do që të jetë, vetëm me i mbledhë në një sallë e me i falënderuar për kontributin që kanë dhënë, për punën e tyre. Mendoj që ata janë shumë modest dhe kishim bërë një nder të veçantë, ndërkohë me e lidhë edhe me 8 Marsin, sepse aty kemi veterane që janë edhe për 7 edhe për 8 Mars.

Fatmir Dervishi, kryesues duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Brajshori tha se nuk e di a kanë përgatitur diçka me rastin e 7 Marsit nuk kam informacion, ndërsa për bursa po, bursa ndajnë por numrin nuk e di.

Lindita Rexhepi, shtroi pyetje se një student i cili përfiton bursë nga universiteti a ka të drejtë të përfitojë bursë edhe nga Komuna.

Fatmir Dervishi, kryesuesi tha se me siguri që po, ose e merr njëren e len tjetren.

Lindita Rexhep, tha se e di edhe unë që ndajnë por si informacion i saktë nuk e di a iu takon nëse janë përfitues në universitet.

Gjylbehare Llapi, tha se edhe unë kam qenë bursiste vetë, kam marr bursë në Fakultet të Edukimit dhe e kam ditur që është nga institucioni publik, nuk mundesh me aplikua edhe në Komunë, ndërsa Komunës i kanë rënë studentët që ndoshta nuk e kanë pasur mesataren prej fakultetit që me e përfituar, por kanë qenë studentë të mirë dhe kanë përfituar nga Komuna. Pra do të thotë se nuk mundesh nga dy institucione publike me përfituar.

Ajet Brajshori, tha se na mbetet të marrim informatën për bursa, sa dhe për cilin nivel, dhe mundësisht një organizim për veteranët e arsimit të Komunës së Prishtinës të cilët kanë dal në pension, me i mbledhë për 7 mars.

Pas shumë propozimesh, sugjerimesh u mor vendim nga anëtarët e komitetit që të bëhet një kërkesë drejtores së Drejtorisë së Arsimit që mundësisht na informoj lidhur me organizimin e një tubimi për veteranët e arsimit të Komunës së Prishtinës.

Ndoshta nuk është një numër i madh, sa do që të jetë, vetëm me i mbledhë në një sallë e me i falënderuar për kontributin që kanë dhënë, për punën e tyre. Mendoj që ata janë shumë modest dhe kishim bërë një nder të veçantë, ndërkohë me e lidhë edhe me 8 Marsin, sepse aty kemi veterane që janë edhe për 7 edhe për 8 Mars.

Mbledhja ka mbaruar në orën 18:30

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Dervishi

